



ZGJEDHJET 17 Nëntor 2007





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E KOSOVËS, ZGJEDHJET PËR KUVENDIN KOMUNAL
DHE ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË KOMUNËS - 2007

UDHËZUES SI TË VOTOHET

I NDERUARI VOTUES,

- NË HYRJE TË VENDVOTIMIT NJË ANËTAR I KOMISIONIT DO T'JU KONTROLLOJË GISHTIN TREGUES ME UVI LLAMBË, PËR TË VËRTETUAR NËSE KENI VOTUAR APO JO MË PARË DITËN E ZGJEDHJEVE.
- NË VENDVOTIM PREJ JUSH DO TË KËRKOHET NJËRA NGA KËTO DOKUMENTE TË IDENTIFIKIMIT: A. LETËRNJOFTIMI VALID I UNMIK-UT, B. DOKUMENTI VALID I UDHËTIMIT I UNMIK-UT, C. PATENTË SHOFERI VALID I UNMIK-UT, D. KARTELA VALIDE E PZHBV-SË, OSE E. KARTELA VALIDE E REFUGJATIT.
- NJË ANËTAR TJETËR I KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT DO TË GJEJË EMRIN TUAJ NË LISTËN VOTUESE DHE JU DO TË NËNSHKRUANI PRANË EMRIT TUAJ.
- PASI TË IDENTIFIKOHENI, NJË ANËTAR TJETËR DO T'JU SPËRKAS GISHTIN E DORËS SË DJATHTË ME NJË NGJYRË TË PADUKSHME, PASTAJ DO TË MERRNI TRE FLETËVOTIME TË PALOSURA DHE TË VULOSURA NË NJË SKAJ.
- NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË KOSOVËS DHE KUVEND KOMUNAL, DO TË SHËNJONI KATRORIN KU ËSHTË I VENDOSUR NUMRI DHE EMRI I SUBJEKTIT POLITIK. NË ANËN E DJATHTË, JANË NUMRAT E KANDIDATËVE, QË JU DO TË SHËNJONI. EMRAT E KANDIDATËVE DO T'I GJENI NË BROSHURAT E KANDIDATËVE, QË GJINDEN NË KABINËN E VENDVOTIMIT. JU MUND TË SHËNJONI MË SË SHUMTI DERI NË 10 NUMRA TË KANDIDATËVE TË PO ATIJ SUBJEKTI POLITIK.
- PËR KRYETAR KOMUNE, KENI TË DREJTË TË VOTONI VETËM NJË KANDIDAT NGA FLETËVOTIMI.
- NË KABINËN E VOTIMIT DO TË HYNI I VETËM KU DO TA VENI SHENJËN NË KATRORIN AFËR SUBJEKTIT POLITIK DHE /OSE KANDIDATIT NË TË TRE FLETËVOTIMET.
- FLETËVOTIMET DO T'I PALOSNI DHE DO T'I VENDOSNI NË KUTITË PËRKATËSE TË VOTIMIT.



JU FALEMINDERIT!

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E KOSOVËS, ZGJEDHJET PËR KUVENDIN KOMUNAL
DHE ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË KOMUNËS - 2007



PRISHTINË, Q. PEJTON, RR. M. ULQINAKU, 7,
TEL.+381 38 246 599; KQZ.SEKRETARIATI@CEC-KO.ORG;

WWW.CEC-KO.ORG